



## REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

---

KF.nr.112/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi, në kontestin tregtar administrativ të paditësit “A...” SHPK me seli në Gjilan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “...” SHPK me seli në Prishtinë, rr. “...”, nr. ... , kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, objekt kontesti rivlerësim malli, vlerë kontesti e pa përcaktuar, në seancën e shqyrtimit kryesor-publik të datës 26.10.2022, të mbajtur në mungesë të përfaqësuesit të paditësit, dhe në prani të përfaqësuesit të autorizuar të të paditurës M.K, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “A...” SHPK me seli në Gjilan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “...” SHPK me seli Prishtinë, si e bazuar.
- II. ANULOHET aktvendimi nr.01.3.2.2/10887 i datës 23.09.2020, i Doganës se Kosovës, dhe lënda kthehet në RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

### A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 27.10.2020, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës, respektivisht kundër vendimit nr.

nr.01.3.2.2/10887 të datës 23.09.2020, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të Kodit Doganor, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Në ZBD Prishtinë kemi paraqitur për zhdoganim auto veturat e markave V.... tipi .... dhe V.... tipi ....., dhe me rastin e paraqitjes së mallit doganor, kemi paraqitur të gjithë dokumentacionin përcjellës të këtyre veturave në bazë të së cilave shihet qartë transaksionet mes blerësit dhe shitësit. Dogana i ka rivlerësuar veturat e paraqitura dhe nuk ka arsyetuar pse çmimi fatural i deklaruar është i papranueshëm kur malli është paraqitur në bazë të dokumentacionit të kompletuar dhe të harmonizuar atëherë duhet të arsyetohet pse nuk janë pranuar faturat që kanë përcjellë mallin për shkak që fatura si dokument themelor në qarkullimin ndërkombëtar të mallrave dhe si dokument parësor nga metodat e vlerësimit të mallit duhet të merret në konsideratë. Kërkojmë nga Dogana që të na pranohet vlera reale e paguar për këtë mall doganor sipas nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave pasi që nga dokumentacioni i mallit shihet se është vlerë reale e paguar për shkak se dokumentacioni rrjedh nga shtetet e Unionit Evropian dhe në bazë të kësaj shihet se janë dokumente reale që dëshmojnë vlerën e transaksionit. E paditura nuk e ka arsyetuar bazën ligjore për një veprim të tillë nuk e ka cekur se ku është bazuar ajo kur ka bërë një konstatim se nëse nuk përputhet vlera e mallit me vlerën e katalogut atëherë Dogana e Kosovës duhet ta rivlerësojë mallin bazuar në vlerën e katalogut, për më tepër katalogu nuk është një dokument zyrtar ku vlerat e automjeteve në këtë katalog janë thjesht vlera referuese. Duke u mbështetur në faktet dhe provat e prezantuara kërkojmë nga Gjykata të vendos sipas kësaj ankese dhe të marrë një vendim merititor. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon. Në seancën e shqyrtimit kryesor përfaqësuesi i paditësit nuk prezanton ndonjë ftesën për këtë seancë e ka pranuar me datën 11.10.2022, mirëpo nuk e ka arsyetuar mungesën-mos pjesëmarrjen, andaj edhe Gjykata ka shqyrtuar këtë kontest tregtar administrativ komfor dispozitave të nenit 41 të LKA-së,

E paditura, në përgjigje në padinë e datës 12.02.2021 e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Aktvendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as

edhe me një provë të vetme, andaj i propozon gjykatës që ta refuzoj në tërsi si të pa-bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ta lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm. Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i të paditurës deklaroi se e paditura e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe mbasin në tërësi pranë aktvendimit të kontestuar nr.10887/23.09.2020 duke konsideruar se ky aktvendim është marrë bazuar në dispozitat ligjore në fuqi dhe se pretendimet e subjektit për shkelje ligjore nuk janë mbështetur me asnjë provë të vetme. Andaj i propozojmë gjykatës që të lë në fuqi aktvendimin e atakuar si të bazuar në ligj dhe ta refuzon padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 26.10.2022 ka administruar provat dhe atë: Aktvendimi i Doganës së Kosovës me nr. 10887/23.09.2020, DUD-i R-46905/10.08.2020, R-46910/10.08.2020, Faturat nr. ..., nr. ..., nr. ..., Urdhërpagesat Ndërkombëtare e realizuar në Bankën Raiffeisen datës 14.07.2020, 06.07.2020, Parashtrësia më të dhëna të shitësit dhe blerësit pa titull dhe numër e pa nënshkruar dhe e pa vulosur e datës 08.07.2020, Parashtrësia me nr.3958471/13.07.2020, Përgjigja në padi e datës 12.02.2021, Ankesa e ushtruar në Doganën e Kosovës nr.10887/09.09.2020, Proceset mbi Përcaktimin e vlerës së mallrave të datës 10.08.2020, Kërkesa për plotësim të lëndës e ushtruar në Doganën e Kosovës 10887/14.09.2020.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga DUD-at kontestues i Doganës së Kosovës, deklarimeve në ankesë, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese

fakti se paditësi me datë 10.08.2020, ka paraqitur DUD R-46905 dhe R-46910, për zhdoganim pranë zyrës së brendshme doganore Prishtina. Me tutje nuk është kontestues as fakti se Dogana e Kosovës pas pranimit dhe vlerësimit të DUD-ave kontestues, ne bazë te procesit mbi përcaktimin e vlerës se mallit, malli lëndor është rivlerësuar ne bazë te metodës se gjashte (6) te vlerësimit ne pajtim me nenin 35 të KDA-së, respektivisht ne bazë te dhënave te disponushme, katalogut përkatës schwacke.net, andaj ne këtë rast subjektit në procedurë-paditësit i është ngritur baza doganore, dhe është detyruar që të paguaj taksë doganore më të lartë se të deklaruar me faturën e mallit. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi, me datë 09.09.2020 ka ushtruar ankesë pranë Doganës së Kosovës, e për të cilën ankesë, Dogana e Kosovës me datë 23.09.2020, ka sjell Aktvendimin nr.01.3.2.2/10887, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, e kundër të cilit, paditësi me padinë e datës 27.10.2020, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ pranë kësaj gjykate.

Gjykata nga aktvendimi kontestues vëren se ai përmban të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, te metat e tilla konsistojnë në faktin se arsyetimi i vendimit kontestuese përmban të dhëna te pamjaftueshme dhe jo të plota sa i përket rivlerësimit të mallit lëndor. Në arsyetimin kontestues nuk është dhënë arsyetim i bazuar, përse vlerësimi nuk mund të bëhet me metodën e parë të vlerësimit në vështrim të nenit 33 te Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109, kur paditësi ka prezantuar dokumentacionin valid që dëshmon për çmimin e paguar si dhe nuk konteston asnjë dokumentacion përcjellës, dhe nuk është dhënë asnjë provë për tu dëshmuar se paditësi i ka paguar eksportuesit mbi çmimin e faturës së mallit, për të dëshmuar konstatimin e dhënë se vlera e mallrave të deklaruar për zhdoganim nuk është vlera reale e mallit. Gjykata konstaton se aplikimi i metodës së 6 të vlerësimit në vështrim te nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, është veprim i cili bie ndesh me dispozitat e nenit 33-35 të Kodit Doganor dhe te Akcizave nr.03/L-109, për arsye, se para se të aplikohet metoda e fundit e vlerësimit gjegjësisht metoda e 6 e vlerësimit, duhet te jepen arsyet dhe provat për ta kontestuar vlerën e mallit lëndor.

Gjykata vlerëson se vendimi kontestues, nuk përmban informata të mjaftueshme me të cilën pala e paditur do të mund të kundërshtonte vlerën e paguar përmes faturës, pasi që paditësi deklaratës doganore kontestuese i'a ka bashkëngjitur faturën për mallin lëndor, ndërsa vendimi kontestuese nuk përmban arsyetim konkret mirëpo vetëm një përmbledhje gjeneral dhe pa mbështetje ligjore. Gjykata ka shqyrtuar edhe bazën ligjore sa i përket dokumenteve që parashihen të bashkëngjiten deklaratës Doganore (DUD-t) gjatë zhdoganimit të mallit, dhe vlerëson se në bazë të nenit 123 paragrafi (a) të UA 11/2009 për zbatimin e Kodit Doganor dhe Akcizave shprehimisht parashihen, dokumentet që duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit, *“fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*.

Në procedurën e kontestit tregtar administrativ gjyqësor, gjykata pasi ka shqyrtuar gjithë dokumentacionin e lëndës konstaton se nga konkluzionet e nxjerra në procedurën administrative dhe provave të theksuara në arsyetimet e vendimeve të paditurës, nuk mund të vërtetohet plotësisht gjendja faktike dhe se ekzistojnë kontradikta në mes konstatimeve të cekura pa i arsyetuar mjaftueshëm me prova konkrete.

Mos vërtetimi i plotë i gjendjes faktike, gjykata e konsideron faktin se vendimi i kontestuar nuk përmban arsye për faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike-administrative. Në arsyetim të vendimit kontestues, thuhet se Zyra e Pranimit Qendror ka vepruar drejt kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është çmimi real i paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për t'u paguar për mallin e shitur për eksport përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, mirëpo për gjykatën një konstatim i tillë është tërësisht i pa qëndrueshëm dhe i pa mbështetur në prova materiale, ngase paditësi për faturën REO13508/14.07.2020, të deklaruar me DUD-in R 46905/10.08.2020ka deklaruar transaksionin bankar ndërkombëtar të realizuar në bankës Raiffeisen të datës 14.07.2020, e i cili është i harmonizuar në kuptim të vlerës me faturë dhe në përshkrim të pagesës ka edhe referencë numrin e shasisë së veturës

WVWZZZ1KZBW138981, e i cili është identik me të dhënat sikurse në rubrikën 31 të DUD-it 46905, po ashtu për kontratën e datës 08.07.2020, të deklaruar me DUD-in R 46910/10.08.2020, ka deklaruar transaksionin bankar ndërkombëtar të realizuar në bankës Raiffeisen të datës 06.07.2020, e i cili është i harmonizuar në kuptim të vlerës me faturë dhe në përshkrim të pagesës dhe ka referencë numrin e shasisë së veturës WEVWZZZ1KZCW006539, e i cili është identik me të dhënat sikurse në rubrikën 31, të DUD-it 46910

Gjykata e obligon të paditurën se në rishqyrtim dhe rivendosje, duhet të konstatoj këto pretendime dhe argumente të paditësit dhe të deklarohet lidhur me provat e administruara përkatësisht kontratën, faturën e mallit lëndor, dokumentet e disponueshme për vlerësimin e mallit si dhe transaksionet bankare. Në arsyetimin e vendimit kontestues shihet se paditura nuk ka shqyrtuar të gjitha pretendimet e paditësit për të konstatuar se faturat, dhe dokumentet përcjellëse, përse nuk janë marr për bazë dhe nuk i kane pranuar si valide. Gjykata vlerëson se aktvendimi-akti administrativ duhet të përmban një përmbledhje të konstatimeve faktike bazuar në provat e paraqitura gjate procedimit administrativ ose në faktet e siguruar nga administrata dhe një deklaram të bazës ligjore në të cilën bazohet akti administrativ.

Të metat e mësipërme janë të asaj natyre që e bëjnë të pa mundur vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj aktvendimi i atakuar u deshtë që doemos të anulohet. Me rastin e nxjerrjes së vendimit të ri e paditura të vlerësoj drejt gjendjen faktike që rezulton nga dokumentacioni i mallit dhe të aplikoj drejt dispozitat ligjore me të cilën përcaktohet vlerësimi i mallrave, duke pasur parasysh edhe praktiken doganore në rastet e ngjashme.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43 paragrafi 1 te LKA-se. Në bazë të këtij parimi, Gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon padinë e paditësit, anulon aktvendimin e

kontestuar, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 par.2 të LKA-së e detyron të paditurën, që në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Gjykata thekson se në nenin 33 par.1 të KDAK-së është parashikuar se: *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, ndërsa në nenin 34 par.1 të KDAK-së parashihet që “Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas nenit 33, ajo duhet të përcaktohet sipas renditjes kronologjike të nën-paragrafëve (a), (b), (c) dhe (d) të paragrafit 2, duke filluar nga nën-paragrafi i parë (metoda e dytë), që lejon përcaktimin e asaj vlere, me përjashtim të rasteve në të cilat radha e aplikimit të nën-paragrafëve (c) dhe (d) mund të kapërcehet me kërkesën e deklaruesit; Vetëm në rast kur vlera nuk mund të përcaktohet në bazë të një nën-paragrafi të caktuar, lejohet të aplikohen dispozitat e nën-paragrafit që vjen me radhë menjëherë pas tij”*. Nga këto dispozita ligjore dhe duke pasur parasysh edhe nenin 123 par.1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave, ku parashihet që *“ Dokumentet në vijim duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë: a) fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*, gjykata konstaton se e paditura në rastin konkret, ka vepruar në mënyrë të gabuar kur ka rivlerësuar mallrat e importuara nga paditësi, pa dhënë arsyetim të mjaftueshëm se përse vlerësimi i mallit nuk mund të bëhet me metodën e parë, siç parashihet me ligj, pasi që paditësi rezultoi të ketë dorëzuar dokumentacionin e kompletuar dhe të kërkuar ligjërisht dhe kështu ka dëshmuar edhe vlerën doganore të mallit të importuar dhe çmimin vërtetë të paguar, siç përcaktohet me nenin 33 par.1 të KDAK-së.

Neni 7 Parag 1 dhe 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla, Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat, lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen.”* Nga këto dispozitat Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe

metodave te provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore te përcaktuara me ligj.

Vërejtjet e cekura janë te obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata komfor dispozitave ligjore të 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.112/22 datë 26.10.2022

Bashkëpunëtori Profesional  
Visar GASHI

Gj y q t a r i,  
Fisnik NULI

#### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.